

Konferenca “Përfaqësimi dhe të drejtat e komunitetit turk në Kosovë”

Më 25 prill 2018, në universitetin shtetëror të Stambollit “Yıldız Teknik Üniversitesi”, në bashkëpunim me qendrën për hulumtime ballkanike dhe të Detit të Zi, “BAL-KAR”, u organizua konferenca “Përfaqësimi dhe të drejtat e komunitetit turk në Kosovë”.

Në hapjen e kësaj konference, z.Qamil Bytyçi, drejtor i Qendrës Kulturore të Kosovës në Stamboll, foli për komunitetin turk në Kosovë, për të cilin theksoi se i gëzon të gjitha të drejtat: nga të drejtat në arsim deri te përfaqësimi në institucionet shtetërore.

Më pas, fjalën e mori Afrim Jusufi, student doktrate në Stamboll, i cili tha se turqit në Kosovë kanë shkollimin në gjuhën e tyre amtare, pastaj në disa komuna gjuha turke është gjuhë zyrtare në nivel komune.

Në konferencë u dhanë edhe disa intervista me anëtarë të komunitetit turk në Kosovë.

Në këtë konferencë morën pjesë edhe dekani i Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative, Prof.dr. Kenan AYDIN, dhe drejtori i qendrës “BAL-KAR, Prof.dr. Mehmet HACISALİHOĞLU, ligjërues të tjerë universiteti, kryetarë, anëtarë të kryesisë, anëtarë të shoqatave të ndryshme dhe pjesëtarë të diasporës shqiptare që jetojnë dhe punojnë në Stamboll.



